



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2039 Prot

Vlorë, më 08 . 02 2024

**Dëgjesë Publike**

**“Mbi tarifatat e shërbimit funeral në Bashkinë Vlorë”**

e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”. ( Ora 10.<sup>15</sup>)

Marrin pjesë:

Z.Ermal Dredha/Kryetar i Bashkisë Vlorë ;Znj. Elpiniqi Mërkuri/Kryetare e Këshillit Bashkiak; Anëtarë të KB; Përfaqësues nga administrata e bashkisë; Përfaqësues nga komuniteti dhe media lokale.

Znj.Elpiniqi Mërkuri/Kryetare KB- Përshëndetje dhe ju falenderoj që jeni këtu, për të diskutuar mbi tarifatat e varrimit dhe zhvarrimit që do të parashikohen në buxhet. Dua t’ju njoftoj që në fillim, se nuk ka ngritje të tarifave, por ulje. Shërbimi ka qënë i menaxhuar nga një kompani private, kontrata është mbyllur dhe tani do të kalojë në administrimin e bashkisë këtë vit. Ju kërkoj ndjesë për kryetarin e bashkisë. do të na bashkohet pas pak në takim. Për sa i përket bazës ligjore është Vendimi me Nr.96 datë 07.12.2023 që ka të bëjë me miratimin e taksave dhe tarifave vendore të buxhetit të bashkisë për vitin 2024 dhe kjo dëgjesë vjen për të qënë korrekt me qytetarët. Do ia kaloj fjalën drejtoreshës për të dhenë sqarimet përkatëse.

Znj.Irena Toshkallari/Zvkryetare - Kjo dëgjesë vjen si detyrim ligjor. Tarifatat do miratohen nga bashkia dhe në konsultim me qytetarët.

Znj.Erinolda Lushaj/Drejtoare e NSHP - Në zbatim të urdhrat të kryetarit, grupi i punës, ka analizuar tarifatat dhe çmimet, janë mbështetur në manual. Tarifa e varrimit e cila përfshin punimet, gërmime me krahë, transporti me mjete, struktura monolite, beton, fuqinë punëtore dhe shpenzimet kapitale. Ka qënë 26.500 lekë, kur e menaxhonte kompania private dhe bëhet 21.670 lekë te reja nën administrimin e bashkisë.

Edhe tarifa e zhvarrimit shkon në vlerën 16.124 mijë të reja e cila përfshin gërmimin e dheut, transportin, fuqinë punëtore, shpenzime operative dhe kapital...

Znj.Irena Toshkallari – Janë tarifa që do të vendosen shtesë në vendim të këshillit bashkiak, bashkëlidhur VKB Nr 96.

Z.Ermal Dredha/Kryetar i Bashkisë - Më falni për vonesën.Erinolda e bëri sqarimin. Dua t’ju them që edhe pse në krahasim me qytetet e tjera kemi tarifën me të ulët, përsëri donim të organizonim një dëgjesë me ju, sikurse e kërkon ligji. Shërbimi ka qënë menaxhuar nga privati dhe do të administrohet nga ne tani. Shpresoj ta bëjmë mirë këtë punë, ka ardhur momenti ta zgjidhim këtë punë. Faleminderit.

Znj.Irena Toshkallari: Të lirë për diskutime. Është çështje sensitive.

Z.Sokol Kushta/ Anëtar i KB- Flas si qytetar. S'ka asnjë qytetar që atje mos të ketë ndonjë të afërm. Zhvillimin që ka Vlora., duhet të zhvillohet edhe atje, të kthehet në vend më të pastër, më të qetë, për tu bërë akoma më mirë. 6muaj, janë shumë, jam shumë mbështetës.

Z.Agur Jazaj/Qytetar- Kam problem me ujin. Nuk kemi ujë në Centrale.Shumë problem. Paguajmë ujin e 2010.

Z.Naim Xhelilaj/ Qytetar – Problem varoshi i gjyshit tim i cili ka qënë Dëshmor Atdheu. Është prishur varoshi, Të vihet një pllakatë, ka dhënë jetën për atdheun.

Znj.Irena Toshkallari- Do të takoni drejtoreshën tek NSHP.

Znj.Erinolda Lushaj- Po hajdeni dhe e sqarojmë.

Aleko Simoni/Qytetar – Më vjen mirë që bashkia ka konsideratë të vdekurit. Ka përmirësime, por urgjente është mbushja e disa gropave. Firma që u largua duhet ta rregullonte dhe të mbante përgjegjësi.

Sa për tarifën, nuk kam asnjë ankesë, por ato që thashë në kohë të afërt të bëhen disa rrugica. Mos vini firma që të bëjnë punën shkel e shko.

Z.Ermal Dredha – Idea është, që me kompaninë që ishte, kishim një ngërç ligjor. Shumë mirë është menaxhuar. Por është historiku ynë , i familjarëve tanë. Praktikisht, kalimi i arkivës së pari, hartat, sipërfaqja..maksimumi mund të menaxhohet dhe 2-3 muaj...Ata morrën .. Është një fazë imetiate , do ti shohim dhe ndriçimin, rrugët, parcelën që do të marrim. Është një biznes i qytetit që do ta bëjë, si dhe në bisedime me bashkësitë fetare , me specialistë, pra që të jetë një standart, ...qoftë për hapsirat etj..Pra, që të ketë një standart. Puna e tarifave., ka dhe preferenca të qytetarëve që i duan me 2-kate. Kostot ndryshojnë. Dhe zhvarrimi, do ketë tarifa të ndryshme, Do mundohemi ta bëjmë vetë si bashki, por po nuk mundëm do të bashkëpunojmë dhe me kompani të tjera. Tarifën në fakt, i kemi zbritur.

Qytetar- Ju falenderoj z.kryetar. ju kam parë në televizion,në pastrimin e varrezave. Kam shpresë dhe besim që do të bëhet.Ju uroj suksese dhe punë të mbarë.

Z.Vaso Strakosha/Qytetar( Avokat) – Unë e kam parë atë legjislacion . Të shohim dhe për varrezat murale...shumë kërkojnë dhe krematoriume , sepse si po ndodh, duhet territor shumë i madh.

Z.Ermal Dredha – Për këto kangjellat si do ia bëjmë, pasi pengesat, vështirësi në mirëmbajtje. Duhet parë dhe kjo, punonjësit nuk mund ti mirëmbajnë, vetëm nga kangjellat.

Z.Spiro Borakaj/Qytetar- Pjesa e varrezave duhet mirëmbajtur. Jam shumë i besuar se këtë punë, do ta kryeni me sukses.

Qytetar- Puna e varrezave , që bëhen të mëdha. Ka ardhur koha të bëhen murale , jo të bëhen të mëdha...por duhet ndonjë ligj ...Duhet investuar, tarifën janë të ulëta. Ne këtu bëjmë shumë shpenzime , kemi ca koncepte.. Tarifën janë në rregull. Mos të shtojmë sipërfaqe, por ti bëjmë murale.

Znj.Irena Toshkallari- Për tarifën u ezaurua. Do të merren në konsideratë propozimet tuaja, do të punohet me grupin e punës.

Faleminderit.